

# Standardi Ndërkombëtar i Raportimit Financiar 1

## *Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Herë të Parë*

### Objektivi

---

- 1 Objektivi i këtij SNRF-je është të sigurojë që *pasqyrat financiare* të njësisë ekonomike të parat sipas SNRF1 dhe raportet financiare të ndërmjetme të saj, për pjesë të periudhës së mbuluar nga këto pasqyra financiare, përmbajnë informacion të një cilësie të lartë i cili:
- (a) është transparent për përdoruesit dhe i krahasueshëm për të gjitha periudhat e paraqitura;
  - (b) siguron një pikë të përshtatshme fillimi për kontabilitetin sipas *Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar* (SNRF-ve); dhe
  - (c) mund të realizohet me një kosto që nuk tejkalon përfitimet për përdoruesit.

### Objekti

---

- 2 Një njësi ekonomike do të zbatojë këtë SNRF-në në:
- (a) pasqyrat financiare të parat të saj sipas SNRF1; dhe
  - (b) çdo raportim financiar të ndërmjetëm, nëse ka, që ajo e paraqet, sipas SNK 34 *Raportimi Financiar i Ndërmjetëm*, për një pjesë të periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare të parat të saj sipas SNRF1.
- 3 Pasqyrat financiare të një njësie ekonomike të parat sipas SNRF-ve janë pasqyrat financiare vjetore të parat, në të cilat njësia ekonomike adopton SNRF-të nëpërmjet një deklarimi të qartë dhe pa rezerva në këto pasqyra, për pajtueshmërinë me SNRF-të. Pasqyra financiare sipas SNRF-ve janë pasqyrat financiare të një njësie ekonomike të parat sipas SNRF-ve, në qoftë se për shembull, njësia ekonomike:
- (a) ka paraqitur pasqyrat financiare më të fundit:
    - (i) sipas kërkesave kombëtare, që nuk janë në të gjitha aspektet në koherencë me SNRF-të;
    - (ii) në përputhje me SNRF-të në të gjitha aspektet, me përjashtim të faktit që pasqyrat financiare nuk përmbajnë një deklaratë të qartë dhe pa rezerva se ato janë në pajtim me SNRF-të;
    - (iii) përmbajnë një deklaratë të qartë të pajtueshmërisë me disa, por jo me të gjithë SNRF-të;
    - (iv) sipas kërkesave kombëtare që nuk janë në koherencë me SNRF-të, duke përdorur disa SNRF të veçanta për të kontabilizuar për elementët për të cilët nuk ekzistojnë kërkesa kombëtare; ose
    - (v) sipas kërkesave kombëtare, me një rakordim të disa shumave me shumat e përcaktuara sipas SNRF-ve
  - (b) ka përgatitur pasqyrat financiare sipas SNRF-ve vetëm për përdorim të brendshëm, pa jua bërë ato të disponueshme pronarëve të njësisë ekonomike ose ndonjë përdoruesi tjetër të jashtëm;
  - (c) ka përgatitur një paketë raportimi sipas SNRF-ve për qëllime konsolidimi, pa përgatitur një paketë të plotë të pasqyrave financiare, siç përcaktohet në SNK 1 *Paraqitja e Pasqyrave Financiare*; ose
  - (d) nuk ka paraqitur pasqyra financiare për periudhat e mëparshme.
- 4 SNRF 1 zbatohet kur një njësi ekonomike adopton për herë të parë SNRF-të. Ai nuk aplikohet kur, për shembull, një njësi ekonomike:
- (a) ndërpret paraqitjen e pasqyrave financiare sipas kërkesave kombëtare, të cilat ajo i ka paraqitur më parë, si dhe ndonjë paketë tjetër të pasqyrave financiare që përmbanin një deklaratë të qartë dhe pa rezerva të pajtueshmërisë me SNRF-të;
  - (b) ka paraqitur pasqyrat financiare sipas kërkesave kombëtare në vitin e mëparshëm, dhe këto pasqyra financiare përmbanin një deklaratë të qartë dhe pa rezerva të pajtueshmërisë me SNRF-të; ose

- (c) në vitin e mëparshëm ka paraqitur pasqyrat financiare, që përmbanin një deklaratë të qartë dhe pa rezerva të pajtueshmërisë me SNRF-të, madje edhe nëse audituesit kanë dhënë një raport me rezervë mbi këto pasqyra financiare
- 5 SNRF 1 nuk aplikohet për ndryshimet në politikat kontabël të bëra nga një njësi ekonomike që zbaton SNRF-të. Këto ndryshime i nënshtrohen:
- (a) kërkesave mbi ndryshimet në politikat kontabël të dhëna në SNK 8 *Politikat Kontabël, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet*; dhe
- (b) kërkesave specifike kalimtare të dhëna në SNRF-të e tjera.

## Njohja dhe matja

### Bilanci i Çeljes sipas SNRF1

- 6 Një njësi ekonomike përgatit një bilanc të çeljes sipas SNRF-ve në datën e kalimit sipas SNRF-ve. Kjo është pika e nisjes për kontabilitetin e saj sipas SNRF-ve. Një njësi ekonomike nuk ka nevojë të paraqesë bilancin e saj të çeljes sipas SNRF-ve në pasqyrat e saj të parat financiare sipas SNRF-ve.

### Politikat kontabël

- 7 Një njësi ekonomike do të përdorë të njëjtat politika kontabël në bilancin e çeljes sipas SNRF-ve dhe për të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare të saj, të parat sipas SNRF-ve. Këto politika kontabël duhet të jenë në përputhje me çdo SNRF që është në fuqi në datën e raportimit për pasqyrat financiare të saj, të parat sipas SNRF-ve, me përjashtim të rasteve të specifikuara në paragrafët 13-34B, 36A-36C dhe 37.
- 8 Një njësi ekonomike nuk zbaton versione të ndryshme të SNRF-ve, të cilat kanë qënë në fuqi në data të mëparshme. Një njësi ekonomike mund të zbatojë një SNRF të ri, i cili ende nuk është bërë i detyrueshëm, po që se vetë SNRF1 lejon zbatimin e më hershëm.

#### Shëmbull: Përdorimi koherent i versionit të fundit të SNRF-ve

##### Informacion i përgjithshëm

Data e raportimit për pasqyrat financiare të njësisë ekonomike A, të parat sipas SNRF-ve, është 31 dhjetori 2005. Njësia ekonomike A vendos të paraqesë informacion krahasues në këto pasqyra financiare vetëm për një vit (shih paragrafin 36). Si rezultat, data e kalimit sipas SNRF-ve është fillimi i veprimtarisë së biznesit më 1 janar 2004 (ose, në mënyrë ekuivalente, mbyllja e veprimtarisë së biznesit më 31 dhjetor 2003). Njësia ekonomike A i ka paraqitur pasqyrat financiare vjetore sipas PPPK-ve të mëparshëm për çdo datë 31 dhjetor të çdo viti deri me datën 31 dhjetor 2004.

##### Aplikimi i kërkesave

Njësia ekonomike A i kërkohet të zbatojë SNRF-të, që janë në fuqi për periudhat që përfundojnë më 31 dhjetor 2005, në:

- (a) përgatitjen e bilancit të çeljes sipas SNRF1 të datës 1 janar 2004 dhe
- (b) përgatitjen dhe paraqitjen e bilancit të saj për datën 31 dhjetor 2005 (duke përfshirë shumat krahasuese për vitin 2004), pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin neto dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur me datën 31 dhjetor 2005 (përfshirë shumat krahasuese për vitin 2004) dhe të informacioneve shpjeguese (përfshirë informacion krahasues për vitin 2004).

Në qoftë se një SNRF i ri nuk është bërë akoma i detyrueshëm, por lejon aplikimin e më hershëm, njësia ekonomike A lejohet, por asaj nuk i kërkohet të zbatojë këtë SNRF, në pasqyrat financiare të saj, të parat sipas SNRF-ve.

- 9 Dispozitat kalimtare në SNRF-të e tjera zbatohen për ndryshimet në politikat kontabël të bëra nga një njësi ekonomike që aktualisht përdor SNRF-të. Ato nuk zbatohen për kalimin, sipas SNRF-ve, të një adoptuesi për herë të parë, me përjashtim të rasteve të përmendura në paragrafët 25D, 25H, 34A dhe 34B.

- 10 Me përjashtim të rasteve të përshkruara në paragrafët 13-34B dhe 36A-36C, një njësi ekonomike në bilancin e saj të çeljes sipas SNRF1 duhet:
- (a) të njohë të gjitha aktivet dhe pasivet, njohja e të cilave kërkohet sipas SNRF-ve;
  - (b) të mos njohë zërat si aktive ose pasive nëse SNRF-të nuk e lejojnë njohjen;
  - (c) të riklasifikojë zërat që ajo ka njohur sipas PPPK-ve të mëparshëm si një lloj aktivi, pasivi ose përbërësi të kapitalit neto, të cilat sipas SNRF-ve klasifikohen ndryshe; dhe
  - (d) të zbatojë SNRF-të për matjen e të gjitha aktiveve dhe pasiveve të njohura.
- 11 Politikat kontabël që një njësi ekonomike përdor, në bilancin e saj të çeljes sipas SNRF-ve, mund të ndryshojnë nga ato që ajo ka përdorur për të njëjtën datë duke zbatuar PPPK-të e mëparshme. Rregullimet pasuese rrjedhin nga ngjarjet dhe transaksionet që ndodhin përpara datës së kalimit sipas SNRF-ve. Për këtë arsye, një njësi ekonomike këto rregullime do t'i njohë drejtpërdrejt në fitimet e pashpërndara (ose, nëse mundet, në një kategori tjetër të kapitalit neto) në datën e kalimit sipas SNRF-ve
- 12 Ky SNRF përcakton dy kategori përjashtimesh ndaj parimit që bilanci i çeljes i një njësie ekonomike sipas SNRF-ve duhet të jetë në pajtim me çdo SNRF:
- (a) paragrafët 13-25 H dhe 36A-36C japin përjashtimet nga disa kërkesa të SNRF-ve të tjera.
  - (b) paragrafët 26-34B ndalojnë zbatimin retrospektiv të disa aspekteve të SNRF-ve të tjera.

## Përjashtime nga SNRF- të e tjera

- 13 Një njësi ekonomike mund të zgjedhë të përdorë një ose disa nga përjashtimet e mëposhtëme:
- (a) kombinimet e biznesit (paragrafi 15);
  - (b) *vlerën e drejtë* ose rivlerësimin e *kostos së gjykuar* (paragrafët 16-19);
  - (c) përfitimet e punëmarrësit (paragrafët 20 dhe 20A);
  - (d) diferencat e përkthimit kumulative (paragrafët 21 dhe 22);
  - (e) instrumentat financiarë të përbërë (paragrafi 23);
  - (f) aktivet dhe pasivet e filialeve, pjesëmarrjeve dhe të sipërmarrjeve të përbashkëta (paragrafët 24 dhe 25);
  - (g) paraqitjen e instrumentave financiarë të njohur më parë (paragrafi 25A);
  - (h) transaksionet e pagesave që bazohen në aksione (paragrafët 25B dhe 25C);
  - (i) kontratat e sigurimit (paragrafi 25D)
  - (j) pasivet e daljes nga përdorimi të përfshira në koston e tokës, ndërtesave, makinerive e pajisjeve (paragrafi 25);
  - (k) qiratë (paragrafi 25F);
  - (l) matjen e vlerës së drejtë të aktiveve dhe pasiveve financiare në njohjen fillestare (paragrafi 25G); dhe
  - (m) një aktiv financiar ose aktiv jo-material i përllogaritur në përputhje me KIRFN Marrëveshjet Konçensionare të Shërbimit (paragrafi 25H);

Një njësi ekonomike nuk do të zbatojë këto përjashtime për analogji me elementët e tjerë.

- 14 Disa përjashtime të dhëna më poshtë i referohen vlerës së drejtë. SNRF 3 *Kombinimet e Biznesit* shpjegon mënyrën e përcaktimit të vlerës së drejtë të aktiveve dhe pasiveve të identifikueshme, që blihen në një kombinim biznesi. Një njësi ekonomike i përdor këto shpjegime, në përcaktimin e vlerave të drejta sipas kësaj SNRF-je, përveç rastit kur një SNRF tjetër përmban një udhëzim më specifik në lidhje me përcaktimin e vlerave të drejta për aktivet dhe pasivet në fjalë. Këto vlera të drejta duhet të reflektojnë kushtet që kanë ekzistuar në datën për të cilën ato ishin përcaktuar.

## Kombinimet e biznesit;

- 15 Një njësi ekonomike do të zbatojë kërkesat që jepen në Shtojcën B për kombinimet e biznesit, të cilat njësia ekonomike i ka njohur përpara datës së kalimit sipas SNRF-ve.

## Vlera e drejtë ose rivlerësimi me koston e supozuar

- 16 Një njësi ekonomike mund të zgjedhë që, në datën e kalimit sipas SNRF-ve, të matë me vlerën e drejtë një element të aktiveve afatgjata materiale - toka, ndërtesa, makineri e pajisje dhe këtë vlerë ta përdorë si kosto të supozuar në atë datë.
- 17 Një adoptues për herë të parë mund të zgjedhë që, në datën e kalimit sipas SNRF-ve, për një element të aktiveve afatgjata materiale - toka, ndërtesa, makineri e pajisje, të përdorë një rivlerësim të bërë sipas PPPK-ve të mëparshme, ose përpara datës së kalimit sipas SNRF-ve, dhe ta përdorë atë si koston e supozuar në datën e rivlerësimit, po që se rivlerësimi në datën e rivlerësimit ka qënë plotësisht i krahasueshëm me:
- (a) vlerën e drejtë; ose
  - (b) koston, apo koston e amortizuar sipas SNRF-ve, të korrigjuar për të reflektur për shembull, ndryshimet në indeksin e përgjithshëm ose specifik të çmimit.
- 18 Zgjedhjet e parashikuara në paragrafët 16 dhe 17 mund të përdoren dhe për:
- (a) aktivet afatgjata materiale të investuara, në qoftë se një njësi ekonomike zgjedh të përdorë modelin e koston, të dhënë në SNK 40 *Aktivet Afatgjata Materiale të Investuara*, dhe
  - (b) aktivet jo materiale që plotësojnë:
    - (i) kriterin e njohjes të dhënë në SNK 38 *Aktivet Jo materiale* (duke përfshirë matjen e besueshme të koston fillestare); dhe
    - (ii) kriterin e dhënë në SNK 38 për ri-vlerësimin (përfshirë ekzistencën e një tregu aktiv);
- Një njësi ekonomike nuk duhet të përdorë këto zgjedhje për aktivet apo pasivet e tjera.
- 19 Një adoptues për herë të parë, mund të ketë përcaktuar një kosto të supozuar sipas PPPK-ve të mëparshëm, për disa ose të gjitha aktivet dhe pasivet, duke i matur ato me vlerën e drejtë në një datë të caktuar për shkak të një ngjarje, si për shembull një privatizimi ose një oferte publike fillestare. Ai mund t'i përdorë këto matje me vlerën e drejtë, që rrjedhin nga ngjarje të caktuara, si kosto të supozuar për SNRF-të në datën e asaj matjeje.

## Përfitimet e punëmarrësit

- 20 Sipas SNK 19 *Përfitimet e Punëmarrësit*, një njësi ekonomike mund të zgjedhë të përdorë një metodë “korridor”, e cila disa përfitime dhe humbje aktuariale i lë të panjohura. Zbatimi retrospektiv i kësaj metode kërkon që një njësi ekonomike të ndajë fitimet dhe humbjet neto aktuariale kumulative që nga krijimi i skemës e deri në datën e kalimit sipas SNRF-ve në një pjesë të njohur dhe të panjohur sipas SNRF 1. Megjithatë, një adoptues për herë të parë mund të zgjedhë të njohë të gjitha fitimet dhe humbjet neto aktuariale kumulative në datën e kalimit sipas SNRF-ve, edhe në qoftë se ai përdor metodën korridor për fitimet dhe humbjet neto aktuariale të mëvonshme. Në qoftë se një adoptues për herë të parë përdor këtë zgjedhje, ai duhet ta zbatojë atë për të gjitha skemat.
- 20A Një njësi ekonomike mund të japë informacionet që kërkohen nga paragrafi 120A(p) i SNK 19, ku shpjegohen shumat e përcaktuara në mënyrë prospektive për secilën periudhë kontabël që nga data e kalimit sipas SNRF-ve.

## Diferencat e përkthimit kumulative

- 21 SNK 21, *Efektet e Ndryshimit në Kurset e Këmbimit* i kërkon një njësi ekonomike që:
- (a) të klasifikojë disa diferenca përkthimi si një komponent të veçantë të kapitalit neto; dhe
  - (b) me perfundimin e një operacioni të kryer jashtë vendit, të transferojë diferencat e përkthimit kumulative të këtij operacioni (përfshirë, nëse është e zbatueshme, fitimet dhe humbjet neto nga mbrojtjet përkatëse) tek pasqyra e të ardhurave, si pjesë e fitimit ose humbjes pas daljes nga përdorimi.
- 22 Megjithatë, një adoptues për herë të parë nuk ka nevojë të respektojë këto kërkesa për diferencat e përkthimit kumulative, të cilat kanë ekzistuar në datën e kalimit sipas SNRF-ve. Në qoftë se një adoptues për herë të parë përdor këtë përjashtim:
- (a) diferencat e përkthimit kumulative për të gjitha operacionet e kryera jashtë vendit janë supozuar se janë zero në datën e kalimit sipas SNRF-ve; dhe
  - (b) fitimi ose humbja neto nga nxjerrja pasuese nga përdorimi e çdo operacioni të kryer jashtë vendit, do të përjashtojë diferencat e përkthimit, që kishin lindur përpara datës së kalimit sipas SNRF-ve, dhe do të përfshijë diferencat e përkthimit të mëvonshme.

## Instrumentat financiarë të përbërë

- 23 *SNK 32 Instrumentat Financiarë: Paraqitja*, kërkon që një njësi ekonomike të ndajë një instrument financiar të përbërë që në fillim, në komponentë të veçantë të pasivit dhe të kapitalit neto. Në qoftë se komponenti i pasivit është i shlyer, përdorimi retrospektiv i SNK 32 përfshin ndarjen e dy pjesëve të kapitalit neto. Pjesa e parë lidhet me fitimet e pashpërndara dhe paraqet interesin kumulativ shtesë në përbërësin e pasivit. Pjesa tjetër përfaqëson përbërësin origjinal të kapitalit neto. Megjithatë, sipas këtij SNRF-je, një adoptues për herë të parë nuk duhet të veçojë këto dy pjesë, në qoftë se përbërësi i pasivit nuk rezulton të jetë i pashlyer në datën e kalimit sipas SNRF-ve.

## Aktivitet dhe pasivitet e filialeve, pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta;

- 24 Në qoftë se një filial bëhet një adoptues për herë të parë më vonë se shoqëria mëmë, filiali, në pasqyrat e tij financiare, mat aktivitet dhe pasivitet e tij me:
- (a) vlerat kontabël që do të përfshiheshin në pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë mëmë, bazuar në datën e kalimit sipas SNRF të shoqërisë mëmë, po qe se nuk janë bërë rregullime për procedurat e konsolidimit dhe për efektet e kombinimit të biznesit, sipas të cilave shoqëria mëmë ka blerë filialin; ose
  - (b) vlerat kontabël që kërkohej nga pjesa pjetër e kësaj SNRF-je, bazuar në datën e kalimit sipas SNRF-ve të filialit. Këto shuma kontabël mund të ndryshojnë nga shumat e përshkruara (a):
    - (i) kur përjashtimet në këtë SNRF rezultojnë në matje që varen nga data e kalimit sipas SNRF-ve.
    - (ii) kur politikatat kontabël të përdorura në pasqyrat financiare të filialit ndryshojnë nga ato të përdorura në pasqyrat financiare të konsoliduara. Për shembull, filiali mund të përdorë si politikë të tij kontabël modelin e kostos, të dhënë në SNK 16, Aktivitet Afatgjatë Materiale - Toka, Ndërtesa, Makineri e Pajisje, ndërsa grupi mund të përdorë modelin e ri-vlerësimit.

Një zgjedhje e ngjashme mund të përdoret edhe nga një pjesëmarrje ose sipërmarrje e përbashkët, që bëhet një adoptues për herë të parë më vonë se sa një njësi ekonomike që ka influencë të konsiderueshme ose kontroll të përbashkët mbi të.

- 25 Megjithatë, në qoftë se një njësi ekonomike bëhet një adoptues për herë të parë më vonë sesa filiali i saj (ose pjesëmarrja apo sipërmarrja e përbashkët), njësi ekonomike, në pasqyrat financiare të konsoliduara të saj, do të matë aktivitet dhe pasivitet e filialit (ose pjesëmarrjes apo sipërmarrjes së përbashkët) me të njëjtat vlera kontabël si në pasqyrat financiare të filialit (ose pjesëmarrjes apo sipërmarrjes së përbashkët), pas rregullimit për konsolidimin dhe rregullimeve kontabël të kapitalit neto, dhe për efektet e kombinimit të biznesit, në të cilën njësi ekonomike ka blerë filialin. Në mënyrë të ngjashme, në qoftë se një shoqëri mëmë bëhet një adoptues për herë të parë për pasqyrat financiare të veçanta të saj, më përpara ose më vonë se sa për pasqyrat financiare të konsoliduara të saj, ajo do të matë aktivitet dhe pasivitet me të njëjtat shuma në të dyja pasqyrat financiare, me përjashtim të rregullimeve për qëllime të konsolidimit.

## Klasifikimi i instrumentave financiarë të njohura më parë

- 25A *SNK 39 Instrumentat Financiarë: Njohja dhe Matja*, lejon që një aktiv financiar të emërtohet (klasifikohet) në njohjen e tij fillestare si gatshëm për shitje ose një instrument financiar (me kusht që ai të plotësojë disa kriteret) të emërtohet si një aktiv ose pasiv financiar me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes. Pavarësisht kësaj kërkesë, në rrethanat e mëposhtme, mund të bëhen përjashtime:
- (a) cdo njësi ekonomike i lejohet të bëjë një klasifikim si të gatshme për shitje, në datën e kalimit sipas SNRF-ve;
  - (b) *një njësi ekonomike që paraqet pasqyrat financiare të parat të saj për një periudhë vjetore që fillon në shtator 2006 ose më pas* – në datën e kalimit sipas SNRF-ve, kjo njësi lejohet të klasifikojë aktivitet ose pasivitet financiar sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, me kusht që në atë datë aktivi ose pasivi të plotësojë kriterin e dhënë në paragrafin 9(b) (i), 9(b) (ii) ose 11 A të SNK 39.
  - (c) *një njësi ekonomike që paraqet pasqyrat financiare të parat të saj, sipas SNRF-ve, për një periudhë vjetore që fillon më 1 janar 2006 ose më pas dhe përpara datës 1 shtatorit 2006* – në datën e kalimit sipas SNRF-ve ajo lejohet të klasifikojë aktivitet ose pasivitet financiar sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes me kusht që në atë datë, aktivi ose pasivi të plotësojë kriteret e dhëna në paragrafin 9(b) (i), 9(b) (ii) ose 11 A të SNK 39. kur data e kalimit sipas SNRF1 është përpara 1 shtatorit 2005, këto klasifikime nuk ka nevojë të bëhen deri më 1 shtator 2005 dhe mund të përfshijnë gjithashtu, aktive dhe pasive financiare, të njohura midis datës së kalimit sipas SNRF-ve dhe datës 1 Shtator 2005.

- (d) *një njësi ekonomike që paraqet pasqyrat financiare të parat të saj, sipas SNRF-ve, për një periudhë vjetore që fillon më 1 janar 2006 dhe zbaton paragrafët 11A, 48A, AG4B, AG33A dhe AG33B dhe amendimet e vitit 2005 në paragrafët 9, 12, dhe 13 të SNK 39 – në fillim të periudhës së raportimit të parë sipas SNRF-ve, kjo njësi lejohet të klasifikojë aktivet ose pasivet financiare sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, me kusht që ato të kualifikohen për këtë klasifikim në përputhje me paragrafët e rinj dhe të amenduar në atë datë. Kur periudha e raportimit të një njësie ekonomike sipas SNRF-ve fillon përpara datës 1 shtator 2005, këto klasifikime nuk ka nevojë të bëhen deri më 1 shtator 2005 dhe mund të përfshijnë dhe aktive dhe pasive financiare të njohura midis fillimit të kësaj periudhe dhe datës 1 shtator 2005. Në qoftë se një njësi ekonomike riparaqet informacion krahasues për SNK 39, ajo duhet të riparaqesë informacionin për aktivet financiare, pasive financiare, grupet e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare ose të të dyjave, të klasifikuar në fillim të periudhës së parë të raportimit sipas SNRF. Këto riparaqitje të informacionit krahasues do të bëhen vetëm në qoftëse elementët ose grupet e përcaktuara në datën e kalimit sipas SNRF-ve do të përmbushnin kriterin për këtë përcaktim, të dhënë në paragrafin 9(b) (i), 9(b) (ii) ose 11 A të SNK 39, ose në qoftëse janë blerë pas datës së kalimit sipas SNRF-ve, në datën e njohjes fillestare do të përmbushnin kriterin e dhënë në paragrafin 9 (b) (i), 9(b) (ii) ose 11A.*
- (e) *për një njësi ekonomike që paraqet pasqyrat financiare të saj, të parat sipas SNRF-ve për një periudhë vjetore që fillon më 1 shtator 2006 - pavarësisht nga paragrafi 91 i SNK 39, çdo aktiv dhe pasiv financiar i kësaj njësie ekonomike, i klasifikuar sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes në përputhje me nënparagrafin e mësipër (c) dhe (d) , i cili më parë ishte klasifikuar si element i mbrojtur në marrëdhëniet kontabël të mbrojtjes së vlerës së drejtë, duhet të ri-klasifikohet nga këto marrëdhënie në kohën kur ato do të klasifikohen sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes.*

### **Transaksionet e pagesës që bazohet në aksione**

- 25B Një adoptues për herë të parë inkurajohet, por nuk kërkohet, që të zbatojë SRNF 2 *Pagesat e bazuara në Aksione*, për instrumente të kapitalit neto që kanë qënë marrë falas më 7 nëntor 2002 ose më parë. Një adoptues për herë të parë inkurajohet gjithashtu, që të përdorë SRNF 2 për instrumentat e kapitalit neto të marra falas pas datës 7 nëntor 2002, të cilat maturohen përpara datës së mëvonshme (a) të kalimit sipas SNRF-ve dhe (b) datës 1 janar 2005. Megjithatë, në qoftë se një adoptues për herë të parë, zgjedh që për këto instrumente të kapitalit neto, të zbatojë SRNF 2, ai mund ta bëjë këtë gjë vetëm në qoftë se njësisia ekonomike ka dhënë informacion shpjegues në mënyrë publike rreth vlerës së drejtë të këtyre instrumentave, të përcaktuara në datën e matjes, siç është përkufizuar në SNRF 2. Megjithatë, për të gjitha grantet e instrumentave të kapitalit neto, për të cilat nuk zbatohet SRNF 2 (për instrumentat e kapitalit neto të marra falas më 7 nëntor 2002 ose përpara kësaj date), një adoptues për herë të parë do të japë informacionin shpjegues të kërkuar nga paragrafët 44 dhe 45 të SRNF 2. Në qoftë se një adoptues për herë të parë modifikon afatet ose kushtet e një granti të instrumentave të kapitalit neto, për të cilat nuk ka qënë zbatuar SNRF 2, njësisia ekonomike nuk kërkohet të zbatojë paragrafët 22-29 të SNRF 2, po qe se modifikimi ka ndodhur përpara datës së mëvonshme të (a) datës së kalimit sipas SNRF-ve dhe (b) datës 1 janar 2005.
- 25C Një adoptues për herë të parë inkurajohet, por nuk kërkohet, të përdorë SRNF 2 për pasivet që krijohen nga transaksionet e pagesës që bazohen në aksione, të cilat janë shlyer përpara datës së kalimit sipas SNRF-ve. Një adoptues për herë të parë inkurajohet gjithashtu, por nuk kërkohet, të përdorë SNRF 2 për pasivet e shlyera përpara datës 1 janar 2005. Për pasivet, për të cilat zbatohet SNRF 2 „një adoptuesi për herë të parë nuk i kërkohet të riparaqesë informacion krahasues deri në shkallën që informacioni lidhet me një periudhë ose datë më të hershme se data 7 nëntor 2002.

### **Kontratat e sigurimit**

- 25D Një adoptues për herë të parë mund të zbatojë dispozitat kalimtare të dhëna në SNRF 4 *Kontratat e Sigurimit*. SNRF 4 kufizon ndryshimet në politikat kontabël për kontratat e sigurimit, duke përfshirë ndryshimet e bëra nga një adoptues për herë të parë.

### **Ndryshimet në pasivet ekzistuese të nxjerrjes nga përdorimi, restaurimi dhe të ngjashme, që përfshihen në koston e aktiveve afatgjata materiale – toka, ndërtesa, makineri e paisje.**

- 25E KIRFN1 *Ndryshimet në Pasivet ekzistuese të nxjerrjes nga përdorimi, restaurimi dhe të ngjashme*, kërkon që ndryshimet e specifikuar në një pasiv të nxjerrjes nga përdorimi, restaurimi ose të ngjashme, të shtohen ose të zbriten nga kostoja e aktivitetit të cilit i përkasin. Shuma e amortizueshme e rregulluar e aktivitetit, më pas amortizohet në mënyrë prospektive përgjatë jetës së dobishme të mbetur. Një adoptues për herë të parë, nuk është e

nevojshme të përmbushë këto kërkesa për ndryshimet në këto pasive, të cilat kanë ndodhur përpara datës së kalimit sipas SNRF-ve. Në qoftë se një adoptues për herë të parë përdor këtë përjashtim, ai duhet:

- (a) matë pasivin në datën e kalimit sipas SNRF-ve në përputhje me SNK 37;
- (b) deri në masën që pasivi është brenda objektit të KIRFN 1, të çmojë shumën që do të kishte qënë përfshirë në koston e aktivit përkatës kur pasivi u krijua për herë të parë, nëpërmjet skontimit të pasivit për atë datë, duke përdorur çmuarjen e tij më të mirë për nivelin e skontimit të korigjurar me nivelin historik të rrezikut, që do të kishte qënë zbatuar për këtë pasiv brenda periudhës së ndërhyrjes. dhe
- (c) në datën e kalimit sipas SNRF-ve, llogarit amortizimin e akumuluar mbi këtë shumë, bazuar në vlerësimin aktual të të jetës së dobishme të aktivit, duke përdorur politikën e amortizimit të adoptuar nga njësia ekonomike sipas SNRF-ve.

## Qiratë

- 25F Një adoptues për herë të parë mund të aplikojë dispozitat kalimtare të dhëna në KIRFN 4 *Përcaktimi nëse një Marrëveshje është Marrëveshje Qiraje*. Prandaj, një adoptues për herë të parë, mund të përcaktojë nëse një marrëveshje, që ekziston në datën e kalimit sipas SNRF-ve, përmban një qira bazuar në faktet dhe rrethanave që ekzistojnë në atë datë.

## Matja e vlerës së drejtë të aktiveve dhe pasiveve financiare

- 25G Pavarësisht nga kërkesat e paragrafëve 7 dhe 9, një njësi ekonomike mund të zbatojë kërkesat që jepen në fjalinë e fundit të SNK 39 AG76 dhe paragrafin AG76A, në njërën nga mënyrë e mëposhtme:
- (a) në mënyrë prospektive për transaksionet e regjistruara pas datës 25 tetor 2002; ose
  - (b) në mënyrë prospektive për transaksionet e regjistruara pas 1 janarit 2004;

## Marrëveshjet Konkensionare të Shërbimit

- 25H Një adoptues për herë të parë mund të zbatojë dispozitat kalimtare që jepen në SNRF 12.

## Përjashtimet nga zbatimi retrospektiv i SNRF-ve të tjera

- 26 Kjo SNRF ndalojnë zbatimin retrospektiv të disa aspekteve të SNRF-ve të tjera, që lidhen me:
- (a) mosnjohjen e aktiveve dhe pasiveve financiare (paragrafët 27 dhe 27A);
  - (b) kontabilitetin mbrojtës (paragrafët 28-30);
  - (c) çmuarjet (paragrafët 31-34); dhe
  - (d) aktivet e klasifikuara si të mbajtura për shitje dhe operacionet jo të vijueshme (paragrafët 34A dhe 34B)

## Mosnjohja e aktiveve dhe pasiveve financiare

- 27 Përveç sa është lejuar nga paragrafi 27A, një adoptues për herë të parë duhet të zbatojë kërkesat e mosnjohjes që jepen në SNK 39 për transaksionet që ndodhin me datën 1 janar 2004 ose pas kësaj date. Me fjalë të tjera, në qoftë se një adoptues për herë të parë nuk njeh aktive ose pasive financiare jo derivative sipas PPPK-ve të tij të mëparshëm, si rrjedhojë e transaksioneve të ndodhura para datës 1 janar 2004, ai nuk do t'i njohë ato aktive dhe pasive sipas SNRF-ve (përveç rasteve kur ato kualifikohen për njohje si rezultat i një transaksioni ose ngjarje të mëvonshme).
- 27A Pavarësisht nga paragrafi 27, një njësi ekonomike mund të zbatojë kërkesat e mosnjohjes të dhëna në SNK 39 në mënyrë retrospektive, duke filluar nga një datë e përzgjedhur nga njësia ekonomike, me kusht që informacioni i cili nevojitet për të zbatuar SNK 39 për mosnjohjen e aktiveve dhe pasiveve financiare, si rezultat i transaksioneve të ndodhura në të shkuarën, ka qënë siguruar në kohën e kontabilitetit fillestar për këto transaksione.

## Kontabiliteti mbrojtës

- 28 Siç kërkohet nga SNK 39, në datën e kalimit sipas SNRF-ve, një njësi ekonomike
- (a) mat të gjitha derivativet me vlerën e drejtë; dhe

- (b) eliminon të gjitha humbjet dhe fitimet neto të shtyra që rrjedhin nga derivativet, të cilët kanë qënë raportuar sipas PPPK-ve të mëparshëm sikur ato të ishin aktive ose pasive.
- 29 Një njësi ekonomike, në bilancin e çeljes sipas SNRF-ve, nuk duhet të reflektojë një marrëdhënie mbrojtëse të një lloji që nuk kualifikohet për kontabilitet mbrojtës sipas SNK 39 (për shembull, shumë marrëdhënie mbrojtëse ku instrumenti mbrojtës është instrument mjetesh monetare, ose një opsion i shkruar; ku elementi i mbrojtur është në një pozicion neto; ose kur mbrojtja mbulon rrezikun e interesit në një investim që mbahet për maturim). Megjithatë, nëqoftëse një njësi ekonomike ka përcaktuar një pozicion neto si një element të mbrojtur sipas PPPK-ve të mëparshme, ajo mund ta klasifikojë një element individual brenda atij pozicioni neto, si një element të mbrojtur sipas SNRF-ve, me kusht që ajo nuk vepron më kështu më vonë se data e kalimit sipas SNRF-ve.
- 30 Në qoftë se përpara datës së kalimit sipas SNRF-ve një njësi ekonomike ka përcaktuar një transaksion si një mbrojtje, por mbrojtja nuk plotëson kushtet për kontabilitetin mbrojtës, të parashikuara në SNK 39, njësia ekonomike do të zbatojë paragrafët 91 dhe 101 të SNK 39 (të rishikuara në vitin 2003) për të mos vazhduar kontabilitetin mbrojtës. Transaksionet e kryera përpara datës së kalimit sipas SNRF-ve nuk do të klasifikohen në mënyrë retrospektive si mbrojtje.

## Çmuarjet

- 31 **Çmuarjet e një njësie ekonomike sipas SNRF-ve, në datën e kalimit sipas SNRF-ve, duhet të jenë në përputhje me çmuarjet e bëra për të njëjtën datë sipas PPPK-ve të mëparshëm (pas rregullimeve që bëhen për të reflektuar ndonjë ndryshim në politikat kontabël) përveç rastit kur ka evidencë objektive që dëshmon se këto çmuarje kanë qënë të gabuara.**
- 32 Një njësi ekonomike mund të marrë informacion rreth çmurjeve të bëra sipas PPPK-ve të mëparshme, pas datës së kalimit sipas SNRF-ve. Sipas paragrafit 31 një njësi ekonomike do ta trajtojë marrjen e këtij informacioni në të njëjtën mënyrë si edhe ngjarjet që ndodhin pas datës së bilancit, të cilat nuk kërkojnë rregullime sipas SNK 10 *Ngjarjet që ndodhin pas Datës së Bilancit*. Për shembull, le të supozojmë se data e kalimit sipas SNRF-ve, për një njësi ekonomike është 1 janar 2004 dhe informacioni i ri i datës 15 qershor 2004 kërkon përsëritjen e një çmurjeje që është bërë sipas PPPK-ve të mëparshëm më datën 31 dhjetor 2003. Njësia ekonomike nuk do të reflektojë këtë informacion të ri në bilancin e saj të çeljes sipas SNRF-ve (përveç rasteve kur çmuarjet duhen rregulluar për ndonjë ndryshim në politikat kontabël ose kur ka evidencë objektive që dëshmon se çmuarjet kanë qënë të gabuara). Në vend të saj, njësia ekonomike do ta reflektojë këtë informacion të ri në pasqyrën e të ardhurave (ose, në qoftë se është e përshtatëshme, në ndryshimet e tjera në kapitalin neto) për vitin e mbyllur me datën 31 dhjetor 2004.
- 33 Një njësi ekonomike mund të ketë nevojë të bëjë çmuarje sipas SNRF-ve në datën e kalimit sipas SNRF-ve, të cilat sipas PPPK-ve të mëparshëm, nuk kërkoheshin në atë datë. Për të arritur koherencën me SNK 10, këto çmuarje sipas SNRF-ve do të reflektojnë kushtet që kanë ekzistuar në datën e kalimit sipas SNRF-ve. Veçanërisht, çmuarjet në datën e kalimit sipas SNRF-ve për cmimet e tregut, nivelet e interesave ose kurset e këmbimit duhet të reflektojnë kushtet e tregut që kanë ekzistuar në atë datë.
- 34 Paragrafët 31-33 përdoren për bilancin e çeljes sipas SNRF1. Ato zbatohen edhe për në një periudhë krahasuese të paraqitur në pasqyrat financiare të njësisë ekonomike të parat sipas SNRF1, rast në të cilin referencat tek data e kalimit sipas SNRF-ve, janë zëvendësuar me referencat tek fundi kësaj periudhe krahasuese.

## Aktivet e klasifikuara për shitje dhe operacionet jo të vijueshme

- 34A SNRF 5 *Aktivet Afatgjata të Mbajtura për Shitje dhe Operacionet jo të vijueshme* kërkon zbatimin prospektiv për aktivet afatgjata (ose grupet e nxjerra nga përdorimi) që plotësojnë kriterin për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje dhe operacionet që plotësojnë kriterin për t'u klasifikuar si jo të vijueshme pas datës së hyrjes në fuqi të SNRF 5. SNRF 5 lejon që një njësi ekonomike të zbatojë kërkesat e SNRF1 për të gjitha aktivet afatgjata (ose grupet e nxjerra nga përdorimi) që plotësojnë kriterin për t'u klasifikuar si të mbajtura për shitje dhe operacionet që plotësojnë kriterin për t'u klasifikuar si jo të vijueshme, pas çdo date përpara datës së hyrjes në fuqi të SNRF-ve, me kusht që vlerësimet dhe informacionet e tjera që nevojiten për të zbatuar SNRF-të, kanë qënë siguruar në kohën që u plotësuan këto kritere.
- 34B Një njësi ekonomike me një datë të kalimit sipas SNRF përpara 1 janarit 2005 do të zbatojë dispozitat kalimtare të SNRF 5. Një njësi ekonomike me një datë të kalimit sipas SNRF-ve më 1 janar 2005 ose më vonë, duhet zbatojë SNRF 5 në mënyrë retrospektive.



## Paraqitja dhe dhënia e informacioneve shpjeguese

- 35 Me përjashtim sa përshkruhet në paragrafët 36a-37, kjo SRNF nuk parashikon përjashtime nga kërkesat për paraqitje dhe dhënie informacioni shpjegues, të parashikuara në SNRF- të e tjera.

### Informacion krahasues

- 36 Për të qënë në pajtim me SNK 1, pasqyrat financiare të një njësie ekonomike të parat sipas SNRF-ve, duhet të përfshijnë informacion krahasues sipas SNRF-ve të paktën për një vit.

### Përjashtime nga kërkesat për të riparaqitur infomacionin krahasues për SNK 39 and SNRF 4

- 36A Në pasqyrat financiare të parat sipas SNRF1, një njësi ekonomike që adopton SNRF-të përpara datës 1 janar 2006, duhet të paraqesë informacion krahasues të paktën për një vit, por ky informacion krahasues nuk është e nevojshme të jetë në pajtim me SNK 32, SNK 39 ose SNRF 4. Një njësi ekonomike që zgjedh të paraqesë informacione krahasuese që nuk janë në pajtim me SNK 32, SNK 39 ose SNRF 4, në vitin e parë të kalimit duhet të:

- aplikojë kërkesat e njohjes dhe të matjes të PPPK-ve të mëparshëm në informacionin krahasues për instrumentat financiare që janë brenda objektit të SNK 32 dhe SNK 39 dhe për kontratat e sigurimit brenda objektit të SNRF 4.
- shpjegojë këtë fakt me bazën e përdorur për të përgatitur këtë informacion; dhe
- shpjegojë natyrën e rregullimeve kryesore që do ta bënin informacionin të ishte në pajtim me SNK 32, SNK 39 dhe SNRF 4. Njësia ekonomike nuk është e nevojshme që të japë informacione sasiore për këto rregullime. Megjithatë, njësia ekonomike duhet të trajtojë çdo rregullim midis bilancit në datën e raportimit të periudhës krahasuese (d.m.th. bilancit që përfshin informacion krahasues sipas PPPK –ve të mëparshme) dhe bilancit në fillim të periudhës së parë të raportimit sipas SNRF-ve (d.m.th. periudhës së parë që përfshin informacionin, i cili është në pajtim me me SNK 32, SNK 39 dhe SNRF 4) që rrjedh nga një ndryshim në politikën kontabël, dhe të japë informacionet shpjeguese që kërkohen nga paragrafi 28(a) –(e) dhe (f)(i) të SNK 8. Paragrafi 28(f)(i) zbatohet vetëm për shumatat e paraqitura në bilanc në datën e raportimit të periudhës krahasuese.

Në rastin e një njësie ekonomike, e cila zgjedh të paraqesë informacion krahasues që nuk është në pajtim me SNK 32, SNK 39 dhe SNRF 4, referenca tek “data e kalimit sipas SNRF-ve”, vetëm në rastin e këtyre standardeve, do të nënkuptojë fillimin e periudhës së parë të raportimit sipas SNRF1. Këto njësi ekonomike duhet të jenë në pajtim me paragrafin 15(c) të SNK 1 dhe të japin informacion shpjegues shtesë, kur pajtueshmëria me kërkesat specifike të SNRF-ve është e pamjaftueshme, për tu lejuar përdoruesve të kuptojnë ndikimin e transaksioneve të veçanta, ngjarjeve dhe kushteve të tjera mbi pozicionin dhe performancën financiare të njësisë ekonomike.

### Përjashtime nga kërkesat për të paraqitur informacion krahasues për SNRF 6

- 36B Një njësi ekonomike që adopton SNRF-të përpara datës 1 janar 2006 dhe zgjedh të adoptojë SNRF 6 *Eksplorimi dhe Vlerësimi i Burimeve Minerare* para datës 1 janar 2006, nuk ka nevojë të zbatojë kërkesat e SNRF 6 për informacionin krahasues të paraqitur në pasqyrat financiare të parat sipas SNRF-ve.

### Përjashtime nga kërkesat për të dhënë informacion shpjegues krahasues për SNRF 7

- 36C Një njësi ekonomike që adopton SNRF-të përpara datës 1 janar 2006 dhe zgjedh të adoptojë SNRF 7 *Instrumentat Financiarë*: nuk është nevoja të paraqesë *informacionet shpjeguese* krahasuese që kërkohen nga SNRF 7 në informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare të parat sipas SNRF-ve.

### Informacioni krahasues dhe përmbledhjet historike jo sipas SNRF-ve

- 37 Disa njësi ekonomike paraqesin përmbledhje historike të të dhënave të përzgjedhura për periudhat përpara periudhës së parë për të cilën ato kanë paraqitur informacion krahasues të plotë sipas SNRF-ve. Kjo SNRF nuk kërkon që këto përmbledhje të jenë në pajtim me kërkesat për njohjen dhe matjen sipas SNRF-ve. Për më tepër, disa njësi ekonomike paraqesin informacion krahasues sipas PPPK-ve të mëparshëm, si dhe informacionin

krahasues që kërkohet nga SNK 1. Në çdo pasqyrë financiare që përmban përmbledhje historike ose informacion krahasues sipas PPPK të mëparshëm, njësia ekonomike duhet të:

- (a) emërtojë informacionin e përgatitur sipas PPPK të mëparshëm në mënyrë të dukshme si informacion që nuk është përgatitur sipas SNRF-ve; dhe
- (b) japë informacione shpjeguese për natyrën e rregullimeve kryesore që do të duhej të bëheshin, për ta bërë atë në pajtim me SNRF-të; Një njësi ekonomike nuk ka nevojë të japë informacione sasiore për këto rregullime.

## Shpjegimi i kalimit sipas SNRF1

**38 Një njësi ekonomike duhet të shpjegojë ndikimin që ka kalimi nga PPPK-të e mëparshme në SNRF-të, në pozicionin e saj financiar të raportuar, në performancën financiare dhe flukset monetare.**

### Rakordimet

39 Për të qënë në pajtim me paragrafin 38, pasqyrat financiare të njësisë ekonomike të parat sipas SNRF1 duhet të përrfshijnë:

- (a) rakordimet e kapitalit të saj neto të raportuar sipas PPPK-ve të mëparshëm me kapitalin neto sipas SNRF-ve për të dyja datat e mëposhtëme:
  - (i) datën e kalimit sipas SNRF-ve dhe
  - (ii) fundin e periudhës më të fundit, të paraqitur në pasqyrat financiare më të fundit të njësisë ekonomike, sipas PPPK-ve të mëparshme;
- (b) një rakordim të fitimit ose humbjes së raportuar sipas PPPK-ve të mëparshëm për periudhën më të vonshme në pasqyrat financiare vjetore më të fundit të njësisë ekonomike me humbjen ose fitimin sipas SNRF-ve për të njëjtën periudhë, dhe
- (c) në qoftë se njësi ekonomike ka njohur ose anuluar ndonjë humbje nga zhvlerësimi për herë të parë në përgatitjen e bilancit të çeljes sipas SNRF1, informacionet shpjeguese që do të kërkoheshin nga SNK 36 *Zhvlerësimi i Aktiveve*, po qe se njësi ekonomike do t'i kishte njohur këto humbje nga zhvlerësimi ose anulime, në periudhën që fillon në datën e kalimit sipas SNRF-ve.

40 Rrakordimet e kërkuara nga paragrafi 39(a) dhe (b) duhet të japin detaje të mjaftueshme për të bërë të mundur që përdoruesit të kuptojnë rregullimet materiale në bilanc dhe në pasqyrën e të ardhurave. Në qoftë se një njësi ekonomike ka paraqitur një pasqyrë të flukseve monetare sipas PPPK-ve të mëparshme, ajo duhet të shpjegojë gjithashtu, rregullimet materiale që duhen bërë për pasqyrën e flukseve të mjeteve monetare.

41 Në qoftë se një njësi ekonomike vihet në dijeni të gabimeve të bëra sipas PPPK-ve të mëparshme, rakordimet e kërkuara nga paragrafi 39(a) dhe (b) duhet të dallojnë korrigjimin e këtyre gabimeve nga ndryshimet në politikat kontabël.

42 SNK 8 nuk trajton ndryshimet në politikat kontabël që ndodhin kur një njësi ekonomike adopton për herë të parë SNRF-të. Për këtë arsye, kërkesat e SNK 8 për dhënie të informacioneve shpjeguese, në lidhje me ndryshimet në politikat kontabël, nuk zbatohen në pasqyrat financiare të një njësie ekonomike të parat sipas SNRF-ve.

43 Nëse një njësi ekonomike nuk ka paraqitur pasqyrat financiare për periudhat e mëparshme, pasqyrat financiare të saj, të parat sipas SNRF-ve, duhet të japin informacione shpjeguese për këtë fakt.

### Emërtimi i aktiveve financiare ose pasiveve financiare

43A Një njësi ekonomike lejohet të klasifikojë një aktiv financiar ose një pasiv financiar të njohur më parë si një aktiv ose pasiv financiar me vlerë të drejtë nëpërmjet humbjes apo fitimit ose si një aktiv financiar të gatshëm për shitje në përputhje me paragrafin 25A. Njësi ekonomike duhet të japë informacion shpjegues rreth vlerës së drejtë të aktiveve financiare ose pasiveve financiare të klasifikuara në secilën kategori në datën e emërtimit dhe të klasifikimit të tyre dhe për vlerën kontabël në pasqyrat financiare të mëparshme.

### Përdorimi i vlerës së drejtë si kosto e supozuar

44 Në qoftë se një njësi ekonomike përdor, në bilancin e çeljes sipas SNRF-ve, vlerën e drejtë si kosto të supozuar për një zë të aktiveve afatgjata materiale - toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje, ose të aktiveve jo materiale (shih

paragrafët 16 dhe 18) pasqyrat financiare të njësisë ekonomike, të parat sipas SNRF-ve, duhet të japin informacione shpjeguese për çdo zë në bilancin e çeljes sipas SNRF-ve:

- (a) totalin e këtyre vlerave të drejta dhe
- (b) rregullimin total të vlerave kontabël të raportuara sipas PPPK-ve të mëparshme.

## Raportet financiare të ndërmjetme

- 45 Për të qënë në pajtim me paragrafin 38, në rastet kur një njësi ekonomike paraqet një raport financiar të ndërmjetëm sipas SNK-së 34 për pjesë të periudhës së mbuluar nga pasqyrat financiare të parat sipas SNRF-ve, njësia ekonomike, përveç kërkesave të SNK 34, duhet të plotësojë edhe kërkesat e mëposhtme:
- (a) Çdo raport i tillë i ndërmjetëm, në qoftë se njësia ekonomike ka paraqitur një raport financiar të ndërmjetëm për periudhën e ndërmjetme të krahasueshme të vitit financiar pararendës, duhet të përfshijë rakordimin e:
    - (i) kapitalit neto të saj sipas PPPK-ve të mëparshme në fund të asaj periudhe të ndërmjetme të krahasueshme me kapitalin neto sipas SNRF-ve në atë datë. dhe
    - (ii) fitimet ose humbjet e tij sipas PPPK-ve të mëparshme për atë periudhë të ndërmjetme të krahasueshme (aktuale dhe progresive nga fillimi i vitit) me fitimin ose humbjen sipas SNRF-ve për atë periudhë.
  - (b) Përveç rakordimeve që kërkohen nga (a) raporti financiar i ndërmjetëm i parë i një njësisë ekonomike sipas SNK 34 për pjesë të periudhës të mbuluar nga pasqyrat financiare të parat sipas SNRF-të, duhet të përfshijë rakordimet e përshkruara në paragrafin 39(a) dhe (b) (plotësuar me detajet që kërkohen nga paragrafët 40 dhe 41) ose një referencë të kryqëzuar me një dokument tjetër të botuar që përfshin këto rakordime.
- 46 SNK 34 kërkon dhënie e informacioneve shpjeguese minimale të cilat bazohen në supozimin që përdoruesit e raporteve financiare të ndërmjetme kanë gjithashtu akses në pasqyrat financiare vjetore të kohëve më të fundit. Megjithatë, SNK 34 kërkon gjithashtu, që një njësi ekonomike të japë informacion shpjegues për “çdo ngjarje apo për transaksionet që janë materiale për të kuptuar periudhën e ndërmjetme aktuale”. Për këtë arsye, në qoftë se një adoptues për herë të parë, në pasqyrat financiare vjetore më të fundit sipas PPPK-ve të mëparshme, nuk ka dhënë informacionet shpjeguese që janë materiale për të kuptuar periudhën e ndërmjetme aktuale, raporti financiar i ndërmjetëm i saj duhet të japë shpjegime për këtë informacion ose të përfshijnë një referencë të kryqëzuar tek një tjetër dokument i botuar që e përfshin atë.

## Data e hyrjes në fuqi

- 47 Një njësi ekonomike duhet të zbatojë këtë SNRF në qoftë se pasqyrat financiare të saj të parat sipas SNRF-ve janë për një periudhë që fillon më datën 1 janar 2004 ose më pas. Inkurajohet zbatim i mëhershëm. Në qoftë se pasqyrat financiare të parat sipas SNRF-ve janë për një periudhë që fillon përpara datës 1 janar 2004 dhe njësia ekonomike zbaton këtë SNRF në vend të KIS-8 *Zbatimi për Herë të Parë i SNK-ve si Bazë Kryesore Kontabël*, ajo duhet të japë informacion shpjegues për këtë fakt.
- 47A Një njësi ekonomike do të zbatojë amendimet që jepen në paragrafët 13(j) dhe 25E për periudhat vjetore që fillojnë me datën 1 Shtator 2004 e pas kësaj date. Në qoftë se një njësi ekonomike zbaton KIRFN 1 për një periudhë më të hershme, këto amendime do të zbatohen edhe për periudhën më të hershme.
- 47B Një njësi ekonomike do të zbatojë amendimet që jepen në paragrafët 13(k) dhe 25F për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2006 ose më vonë. Nëse një njësi ekonomike zbaton KIRFN 4 për një periudhë më të hershme, këto amendime do të aplikohen për këtë periudhë më të hershme.
- 47C Një njësi ekonomike do të zbatojë amendimet që jepen në paragrafin 36B për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2006 ose më vonë. Në qoftë se një njësi ekonomike zbaton SNRF 6 për një periudhë më të hershme, këto amendime do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.
- 47D Një njësi ekonomike do të zbatojë amendimet që jepen në paragrafin 20A për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2006 ose më vonë. Në qoftë se se një njësi ekonomike zbaton SNK 19 *Përfitimet e Punonjësve – Fitimet dhe Humbjet Neto Aktuariale*, Informacione Shpjeguese për Skemat e Grupuar, për një periudhë më të hershme, këto amendime do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.
- 47E Një njësi ekonomike do të zbatojë amendimet që jepen në paragrafët 13(l) dhe 25G për periudhat vjetore që fillojnë më datën 1 janar 2005 ose më vonë. Në qoftë se një njësi ekonomike zbaton amendimet e SNK 39 *Instrumentet financiare: Njohja dhe Matja — Kalimi dhe Njohja Fillestare e Aktiveve dhe Pasiveve Financiare*, për një periudhë më të hershme, këto amendime do të zbatohen për këtë periudhë më të hershme.

## Shtojcë A

### Termt e përkufizuar

*Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF1.*

<b>Data e kalimit sipas SNRF-ve</b>	Fillimi i periudhës më të hershme për të cilën një njësi ekonomike paraqet informacion të plotë krahasues sipas SNRF-ve <b>në pasqyrat financiare të saj të parat sipas SNRF1.</b>
<b>kosto e supozuar</b>	Një shumë e përdorur si një zëvendësues për koston ose koston e amortizuar në një datë të dhënë. Amortizimi i mëpasshëm nënkupton që njësi ekonomike e kishte njohur fillimisht aktivin ose pasivin në një datë të dhënë dhe kostoja e tij ka qënë e barabartë me koston e supozuar.
<b>vlera e drejtë</b>	Shuma me të cilën mund të këmbehet një aktiv ose pasiv midis palëve të mirëinformuara, të vullnetëshme dhe të palidhura me njëra tjetrën në një transaksion pa pengesa.
<b>pasqyrat financiare të parat sipas SNRF1</b>	Pasqyrat financiare vjetore të parat në të cilat njësi ekonomike adopton <b>Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)</b> , me anën e një deklarate të qartë dhe pa rezerva të pajtueshmërisë me SNRF-te.
<b>periudha e parë e raportimit sipas SNRF</b>	Periudha e raportimit që përfundon në <b>datën e raportimit të</b> pasqyrave financiare të njësisë ekonomike, të parat sipas SNRF-së.
<b>adoptues për herë të parë</b>	Një njësi ekonomike që paraqet <b>pasqyrat financiare të parat sipas SNRF1</b>
<b>Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF)</b>	Standardet dhe Interpretimet e miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Ato përfshijnë: <ul style="list-style-type: none"> <li>(a) Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;</li> <li>(b) Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit; dhe</li> <li>(c) Interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve për Raportimin Financiar Ndërkombëtar (KIRFN) ose dikur Komiteti në Pozitë për Interpretimet (KIS).</li> </ul>
<b>bilanci i çeljes sipas SNRF</b>	Bilanci i një njësie ekonomike (i botuar ose i pabotuar) në <b>datën e kalimit sipas SNRF-ve.</b>
<b>PPPK – të e mëparshme</b>	Baza kontabël më e fundit që ka përdorur <b>një adoptues për herë të parë</b> përpara adoptimit të SNRF-ve
<b>data e raportimit</b>	Fundi i periudhës më të vonëshme të mbuluar nga pasqyrat financiare ose nga një raporti financiar i ndërmjetëm.

# Shtojcë B

## Kombinimet e biznesit;

*Kjo shtojcë është pjesë përbërëse e SNRF1.*

- B1 Një adoptues për herë të parë mund të zgjedhë të mos zbatojë SNRF 3 *Kombinimet e biznesit* në mënyrë retrospektive për kombinimet e biznesit të bëra në të shkuarën (kombinime biznesi që kanë ndodhur përpara datës së kalimit sipas SNRF-ve). Megjithatë, në qoftë se një adoptues për herë të parë, për të qënë në pajtim me SNRF 3, riparaqet ndonjë kombinim biznesi, ai duhet të riparaqesë të gjitha kombinimet e biznesit të mëvonshme dhe duhet të zbatojë gjithashtu, SNK 36 *Zhvlerësimi i aktiveve* (rishikuar në 2004) dhe SNK 38 *Aktivet jo-materiale* (rishikuar në 2004) nga e njëjta datë. Për shembull, në qoftë se një adoptues për herë të parë zgjedh të riparaqesë një kombinim biznesi që ka ndodhur më 30 qershor 2002, ai do të riparaqesë të gjitha kombinimet e biznesit që kanë ndodhur në periudhën midis 30 qershorit 2002 dhe datës së kalimit sipas SNRF, dhe do të zbatojë gjithashtu, SNK 36 (rishikuar në 2004) dhe SNK 38 (rishikuar në 2004) që nga data 30 qershor 2002.
- B1A Një njësi ekonomike nuk ka nevojë të zbatojë në mënyrë retrospektive SNK 21 *Efektet e ndryshimit në kurset e këmbimit* (rishikuar në 2003) për rregullimet e vlerës së drejtë dhe të emrit të mirë, të cilat vijnë nga kombinimet e biznesit që kanë ndodhur përpara datës së kalimit sipas SNRF-ve. Në qoftë se njësi ekonomike nuk zbaton SNK 21 në mënyrë retrospektive për rregullimet e vlerës së drejtë dhe të emrit të mirë, ajo duhet t'i trajtojë ato si aktive dhe pasive të njësisë ekonomike dhe jo si aktive dhe pasive të blerësit. Për rrjedhojë, këto rregullime të emrit të mirë dhe të vlerës së drejtë ose janë shprehur në monedhën funksionale të njësisë ekonomike ose janë elementë jo-monetarë në monedhë të huaj, të cilët raportohen duke përdorur kursin e këmbimit të aplikuar sipas PPPK-ve të mëparshëm.
- B1B Një njësi ekonomike mund të zbatojë SNK 21 në mënyrë retrospektive për rregullimet e vlerës së drejtë dhe të emrit të mirë që rrjedhin nga:
- (a) të gjitha kombinimet e biznesit që kanë ndodhur përpara datës së kalimit sipas SNRF-ve, ose
  - (b) të gjitha kombinimet e biznesit që një njësi ekonomike zgjedh të riparaqesë për të qënë në pajtim me SNRF 3, sikurse lejohet nga paragrafi B1 më sipër.
- B2 Në qoftë se një adoptues për herë të parë nuk zbaton SNRF 3 në mënyrë retrospektive për një kombinim biznesi të kryer në të shkuarën, për këtë kombinim biznesi ky veprim ka këto pasoja:
- (a) Adoptuesi për herë të parë do të ruajë të njëjtin klasifikim (si një blerje nga blerësi ligjor, një blerje e rimarrë nga blerësi ligjor ose një bashkim interesash) si edhe në pasqyrat financiare të tij sipas PPPK-ve të mëparshme.
  - (b) Adoptuesi për herë të parë duhet të njohë, në datën e kalimit sipas SNRF-ve, të gjitha aktivet dhe pasivet e blera ose të marra nga një kombinim biznesi i kryer në të kaluarën, përveç:
    - (i) disa aktiveve dhe pasiveve financiare që nuk janë njohur sipas PPPK-ve të mëparshme (shiko paragrafin 27); dhe
    - (ii) aktivet, përfshirë emrin e mirë, dhe pasivet që nuk kanë qënë njohur në bilancin e konsoliduar të blerësit, të hartuar sipas PPPK-ve të mëparshme, dhe që gjithashtu nuk do të kualifikoheshin për njohje sipas SNRF-ve në bilancin e vecatë të blerësit (shih paragrafin B2(f)–B2(i)).
- Adoptuesi për herë të parë do të njohë çdo ndryshim që rrjedh nga rregullimi i fitimeve të pashpërndara (ose, nëse është e nevojshme, një tjetër kategori të kapitalit neto), përveç rasteve kur ndryshimet rrjedhin nga njohja e një aktivi jo-material, i cili më parë përfshihej brenda emrit të mirë (shih paragrafin B2(g)(i)).
- (c) Adoptuesi për herë të parë do të përjashtojë prej bilancit të tij të çeljes sipas SNRF-ve, çdo zë të njohur sipas PPPK-ve të mëparshëm, i cili nuk kualifikohet për njohje si një aktiv ose pasiv sipas SNRF-ve. Adoptuesi për herë të parë duhet të llogaritë ndryshimet rezultuese si më poshtë:
    - (i) adoptuesi për herë të parë mund të ketë klasifikuar një kombinim biznesi të kryer në të shkuarën si blerje dhe mund të ketë njohur si një aktiv jo-material një zë që nuk kualifikohet për njohje sipas SNK 38. Ai do ta riklasifikojë këtë zë (dhe, nëse ka, tatimet përkatëse të shtyra dhe interesat e pakicës) si pjesë të emrit të mirë (përveç rasteve kur, sipas PPPK-ve të mëparshme, emri i mirë zbritet drejtpërdrejt nga kapitali neto, shih paragrafin B2(g)(i) and B2(i)).

- (ii) Adoptuesi për herë të parë do të njohë të gjitha ndryshimet e tjera që rezultojnë në fitimet e pashpërndara.\*
- (d) SNRF-të kërkojnë matje pasuese të disa aktiveve dhe pasiveve mbi një bazë që nuk mbështetet në koston fillestare, siç është për shembull, vlera e drejtë. Adoptuesi për herë të parë do të matë me këtë bazë, në bilancin e çeljes sipas SNRF-ve, të gjitha aktivet dhe pasivet, madje edhe në rast se këto kanë qënë blerë ose krijuar në një kombinim biznesi të kryer në të shkuarën. Ai do të njohë çdo ndryshim që rrjedh në vlerën kontabël duke rregulluar fitimet e pashpërndara (ose, nëse nevojitet, një kategori tjetër të kapitalit neto), të ndryshëm nga emri i mirë.
- (e) Menjëherë pas kombinimit të biznesit, vlera kontabël sipas PPPK-ve të mëparshme e aktiveve të blera dhe pasiveve të marra përsipër në atë kombinim biznesi, do të jetë kosto e tyre e supozuar sipas SNRF-ve në atë datë. Në qoftë se SNRF-të kërkojnë një matje të bazuar në kosto të këtyre aktiveve dhe pasiveve në një datë më të mëvonshme, kjo kosto e supozuar do të jetë bazë për amortizimin që mbështetet në kosto ose amortizimin që nga data e kombinimit të biznesit.
- (f) Në qoftë se një aktiv i blerë ose një pasiv i marrë në një kombinim biznesi të kryer në të shkuarën, nuk ishte njohur sipas PPPK-ve të mëparshme, ai nuk ka një kosto të supozuar zero në bilancin e çeljes sipas SNRF1. Në vend të saj, blerësi do ta njohë dhe matë atë në bilancin e konsoliduar të tij, mbi bazën që SNRF-të do të kërkonin në bilancin e biznesit/njesisë së blerë. Për ta ilustruar: në qoftë se blerësi, sipas PPPK-ve të mëparshme, nuk ka kapitalizuar qiratë financiare të blera në një kombinim biznesi të kryer në të shkuarën, ai do t'i kapitalizojë këto qira në pasqyrat e tij të konsoliduara, ashtu siç do të kërkonte SNK 17 *Qiratë* për biznesin/njesisë e blerë të bënte në bilancin e saj sipas SNRF1. Në të kundërt, në qoftë se një aktiv ose detyrim, i cili sipas PPPK-ve të mëparshme ka qënë përfshirë në emrin e mirë, por sipas SNRF 3 do të kishte qënë njohur veças, ky aktiv apo pasiv do të vazhdojë të mbetet në emrin e mirë, përveç rasteve kur SNRF-të do të kërkonin njohjen e tij në pasqyrat financiare të njesisë së blerë.
- (g) Vlera kontabël e emrit të mirë në bilancin e çeljes sipas SNRF-ve do të jetë vlera kontabël sipas PPPK-ve të mëparshme në datën e kalimit sipas SNRF-ve, pas tri rregullimeve të mëposhtëme:
- (i) Në qoftë se kërkohet nga paragrafi B2(c)(i) i mësipërm, adoptuesi për herë të parë duhet të rritë vlerën kontabël të emrit të mirë kur ai riklasifikon një zë, të cilin sipas PPPK-ve të mëparshme, e ka njohur si një aktiv jo-material. Në të njëjtën mënyrë, në qoftë se paragrafi B2(f) kërkon që adoptuesi për herë të parë të njohë një aktiv jo-material që ka qënë nënshumë në njohjen e emrit të mirë sipas PPPK-ve të mëparshme, adoptuesi për herë të parë do të pakësojë vlerën kontabël të emrit të mirë respektivisht (dhe, nëse aplikohet, do të rregullojë tatimin e shtyrë dhe interesat e pakicës).
- (ii) Një eventualitet që ndikon në shumën e blerjes për një kombinim biznesi të ndodhur në të kaluarën mund të jetë zgjidhur përpara datës së kalimit sipas SNRF-ve. Në qoftë se ka mundësi të bëhet një çmuarje e besueshme e rregullimit të kushtëzuar (eventual) dhe në qoftë se pagesa e tij është e mundur, adoptuesi për herë të parë do të rregullojë emrin e mirë me këtë shumë. Në të njëjtën mënyrë, adoptuesi për herë të parë do të rregullojë vlerën kontabël të emrit të mirë në qoftë se një rregullim i kushtëzuar, i njohur më parë, nuk mund të matet më në mënyrë të besueshme ose në qoftë se pagesa e tij nuk është më e mundur.
- (iii) Pavarësisht nëse ka ndonjë indikacion që tregon se emri i mirë mund të jetë zhvlerësuar, adoptuesi për herë të parë duhet të zbatojë SNK 36 për të testuar emrin e mirë për zhvlerësim në datën e kalimit sipas SNRF dhe për njohjen e ndonjë humbje, që vjen si rezultat i zhvlerësimit, në fitimet e pashpërndara (ose, në qoftë se kërkohet nga SNK 36, në plusvlera të rivlerësimit). Testi i zhvlerësimit duhet të bazohet në kushtet që ekzistojnë në datën e kalimit sipas SNRF-ve
- (h) Asnjë rregullim tjetër nuk do të bëhet për vlerën kontabël të emrit të mirë në datën e kalimit sipas SNRF-ve. Për shembull, adoptuesi për herë të parë nuk do të riparaqesë vlerën kontabël të emrit të mirë:
- (i) për të përjashtuar kërkimin dhe zhvillimin e blerë në atë kombinim biznesi (përveç rasteve kur aktiv i jo-material përkatës do të kualifikohej për njohje sipas SNK 38 në bilancin e njesisë ekonomike të blerë);
- (ii) për të rregulluar amortizimin e mëparshëm të emrit të mirë;

\* Ndryshime të tilla përfshijnë riklasifikimet nga ose në aktive jo-materiale nëse emri i mirë nuk është njohur nga PPPK të mëparshme si aktiv. Kjo lind në rastet kur, sipas PPPK të mëparshme, njësia ekonomike (a) e zbriti emrin e mirë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga kapitali neto ose (b) nuk e trajtoi kombinimin e biznesit si një blerje.

(iii) për të anuluar rregullimet për emrin e mirë, të cilat SNRF 3 nuk i lejon, të bëra sipas PPPK-ve të mëparshme për shkak të rregullimeve të aktiveve dhe pasiveve midis datës së kombinimit të biznesit dhe datës së kalimit sipas SNRF-ve.

(i) Në qoftë se adoptuesi për herë të parë e ka njohur emrin e mirë sipas PPPK-ve të mëparshme si zbritje nga kapitali neto:

(i) ai nuk do ta njohë këtë emër të mirë në bilancin e tij çeljes sipas SNRF-ve. Për më tepër, ai nuk do ta transferojë këtë emër të mirë në pasqyrën e të ardhurave, në qoftë se ai likuidon filialin ose në qoftë se investimi në filial zhvlerësohet.

(ii) rregullimet që vijnë si rezultat i zgjidhjes së mëpasshme të një eventualiteti, të cilat kanë ndikim mbi shumën e blerjes, do të njihen në fitimet e pashpërndara.

(j) Sipas PPPK-ve të mëparshme, adoptuesi për herë të parë mund të mos ketë konsoliduar një filial të blerë në një kombinim biznesi të ndodhur në të kaluarën (për shembull për arsye se shoqëria mëmë nuk e kishte konsideruar atë si filial sipas PPPK-ve të mëparshme, ose nuk ka përgatitur pasqyra financiare të konsoliduara). Adoptuesi për herë të parë do të rregullojë vlerat kontabël të aktiveve dhe pasiveve të filialit me shumat që kërkohen të paraqiten sipas SNRF-ve në bilancin e filialit. Kosto e supozuar e emrit të mirë në datën e kalimit sipas SNRF-ve është e barabartë me diferencën midis:

(i) interesit të shoqërisë mëmë në këto vlera kontabël të rregulluara; dhe

(ii) kostos së investimit të saj në filial që është paraqitur në pasqyrat financiare individuale të shoqërisë mëmë.

(k) Matja e interesave të pakicës dhe tatimi i shtyrë vjen si pasojë e matjes së aktiveve dhe pasiveve të tjera. Prandaj, rregullimet e mësipërme për aktivet dhe pasivet e njohura, ndikojnë në interesat e pakicës dhe tatimin e shtyrë.

B3 Përjashtimi për kombinimin e biznesit të ndodhur në të shkuarën aplikohet edhe për blerjet e kaluara të investimeve në pjesëmarrje dhe të interesave në sipërmarrjet e përbashkëta. Për më tepër, data e zgjedhur për paragrafin B1 aplikohet në mënyrë të njëjtë për të gjitha këto blerje.